



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 40.2 shkronjsh e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe nenit 40 paragrafi 2 pikën 5) të Statutit të Komunës së Klinës si dhe në Rregulloren për përmbajtjen e simboleve komunale, si dhe për procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera, me kërkesën nr.01-586-1965/2024 të parashtruar nga Prof. Dr. Lush Culaj, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e II-të të rregullt për vitin 2024 të mbajtur me datën 23.02.2024, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për shqyrtimin e propozimit për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit”

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e propozimit për dhënien e titullit ‘Nderi i Qytetit’ për veprimtarin e çështjes kombëtare prof. Ymer Berisha.

1.1. Komisioni përbëhet nga 7 anëtar:

- Hajdin Morina – Ekzekutivi;
- Fatjona Gashi – Ekzekutivi;
- Kolë Prenaj- KK “;
- Ilirjana Toplanaj- KK;
- Besiana Gashi – KK;
- Blerina Gashi - KK;
- Vitore Zefi - OJQ “Ardhmeria” Klinë.

2. Komisioni, ka për obligim qe të veproj ashtu siç parashihet me rregulloren për përmbajtjen e simboleve komunale, si dhe për procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe pas shqyrtimit të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet në nenin 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

4. Më këtë Vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komisionit, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-6132 /2024
Me datë 28.02 /2024



Kryesuesi
Fadil Gashi